




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 251/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina – Kryetar, z. Nuhi Paçarizi –Referues dhe z. Goran Milenkovic-Anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “Urban Plus” shpk– Prishtinë, kundër rezultateve të konkursit të projektimit të aktivitetit të prokurimit: “Konkurs projektimi për hartimin të projektit ideor arkitektonik Qendra e mjekësisë familjare në Lagjen Prishtina e Re- Zona e Perëndimit”, me nr. prokurimi: 616-19-953-223, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, më datën 29. 05. 2019 mori këtë:

V E N D I M

I.Hedhet si e pa lejuar ankesa e OE “Urban Plus” shpk– Prishtinë, me nr. të protokolli 251/19, e datës: 27 maj 2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Konkurs projektimi për hartimin të projektit ideor arkitektonik Qendra e mjekësisë familjare në Lagjen Prishtina e Re- Zona e Perëndimit”, me nr. prokurimi: 616-19-953-223, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, pasi që ankuesi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në Autoritet kontraktues jashtë afatit ligjor- ne ditën e gjashtë.

II.I LEJOHET autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Konkurs projektimi për hartimin të projektit ideor arkitektonik Qendra e mjekësisë familjare në Lagjen Prishtina e Re- Zona e Perëndimit”, me nr. prokurimi: 616-19-953-223, përkitazi me këtë ankesë, (nëse nuk ka ankesë tjetër).

III. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është e lejuar sipas nenit 108/A të LPP-së dhe nenit 4. b) të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave .

IV. Me qenë se ankesa e OE “Urban Plus” shpk– Prishtinë, hudhet si e pa lejuar i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimi të ankesës.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Më datën 27. 05. 2019, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën e parashtruar nga ana e OE “Urban Plus” sh. p. k– Prishtinë, me nr. te protokollit 251/19 për aktivitetin e prokurimit me titull: “Konkurs projektimi për hartimin të projektit ideor arkitektonik Qendra e mjekësisë familjare në Lagjen Prishtina e Re- Zona e Perëndimit”, me nr. prokurimi: 616-19-953-223, duke pretenduar se:

Data e njoftimit për konkursin e projektimit: 15 mars 2019

Data e njoftimit për rezultat e konkursit të projektimit: 08. 05. 2019

Kërkesa për rishqyrtim është parashtruar me datën 13. 05. 2019 përmes sistemit të e-prokurimit gabimisht tek pjesa për ankesa në OSHP.

Pasiqë ka vërejtur se është dërguar gabim, OE e ka dërguar kërkesën të nesërmen në AK me datën 14. 05. 2019, në ditën e gjashtë dhe jo në ditën e pestë siç është paraparë me ligj.

Vendimi lidhur me kërkesën për rishqyrtim nga AK është bërë me datën 16. 05. 2019

Pas pranimit të ankesës paneli shqyrtues ka mbajtur me datën: 29.05.2019, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, dhe të

gjithë parashtrirat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues konstaton se AK ka publikuar njoftimin me datën 15 mars 2019, konkurs projektimi, vlerë e mesme. OE ankues me datën 13 maj 2019 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim përmes e-prokurimit gabimisht tek pjesa e OSHP-së për parashtrim të ankesave. Pasiqë është vërejtur nga zyrtaret e OSHP-së se kërkesa për rishqyrtim është dorëzuar gabimisht, është kontaktuar përmes telefonit OE ankues dhe i është sqaruar se kërkesën e ka dërguar gabimisht jo në AK por tek pjesa e OSHP. I njëjti me datën 14 maj 2019 (të nesërmen) i është drejtuar AK-së me kërkesë për rishqyrtim dhe një parashtrirë me të cilën ka sqaruar se kanë ngarkuar kërkesën për rishqyrtim në platformën e e-prokurimit në pjesën e OSHP-së dhe nga AK kanë kërkuar që të merret parasysh kërkesa e tyre.

AK me datën 16 maj 2019 me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

Paneli shqyrtues konstaton se bazuar në nenin 4. 1 pika (b) të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave thuhet: **b) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënie të kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.**

Andaj, OSHP duke pasur parasysh faktin se OE ankues nuk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me njoftimin për rezultatet e konkursit të projektimit brenda afatit prej 5 ditëve, dhe kërkesën e ka dërguar gabimisht në OSHP i njëjti ka humbur afatin ligjor për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim në autoritetin kontraktues dhe OSHP nuk mund të shqyrtoj ankesën në fjalë për faktin se ankuesi nuk ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim konform nenit 4. 1 b) të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesën e parashtruar nga OE “Urban Plus” - SH.P.K. Prishtinë, me nr. të protokollit 251/19 dhe ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga operatori ekonomik i cekur si më lart është e pa lejuar pasi që ankuesi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim

në AK që ka pasur të bëjë me njoftimin për rezultatet e konkursit të projektimit brenda afatit prej 5 ditëve dhe kërkesën e ka dërguar në autoritet kontraktues në ditën e gjashtë dhe jo në ditën e pestë pasi që fillimisht atë e ka dërguar tek pjesa e OSHP-së duke mos zënë kështu afatin ligjor për parashtrim si rregullave.

Kryetari i OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Blerim Dina



Vendimi i dorëzohet:

1. 1x1 AK- Komuna Prishtinës
2. 1x1 OE "Urban Plus" - SH.P.K. Prishtinë
3. Arkivës së OSHP-së